



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

	Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS SUĐSKI SAVET KOSOVA KOSOVO JUDICIAL COUNCIL	
	No. 01 / 393	
	DAT.DT. 07.08.2023	
	PRISHTINË - A	

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUĐSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK.nr.382/2023

Data: 28 korrik 2023

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7, paragrafit 1, pika 1.14, të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur për lëndën disiplinore ndaj Lela Petković, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Ferizaj, sipas raportit të panelit hetimor nr.AD/KGJK/16/2022/ GJTHFR-ADGJTHFR.nr.08/22, të datës 8 maj 2023, në bazë të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nenit 19 dhe 20 të Rregullores 05/2019, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve, në seancën dëgjimore të mbajtur me datë 28 korrik 2023, nxjerr:

V E N D I M

Lela Petković, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Ferizaj, nuk është përgjegjëse për shkeljen disiplinore të përcaktuar me nenin 5, paragrafi 2, nënparagrafi 2.7 i Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli) ka pranuar nga Autoriteti Kompetent kërkesë për inicimin e hetimit disiplinor me pretendimin se Lela Petković, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Ferizaj, mund të ketë bërë shkelje disiplinore nga neni 5, paragrafi 2, nënparagrafi 2.7, i Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Në kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor, Autoriteti Kompetent ka marrë parasysh se në bazë të ankesës së gjyqtarja e lëndës, znj. Lela Petković, ka nxjerrë vendim për masën e sigurisë së përkohshme me datë 6 prill 2022, dhe ka tejkalluar të gjitha afatet ligjore pa thirrur seancë gjyqësore në bazë të kundërshtimit i cili është paraqitur me datë 26 prill 2022, edhe pse dy herë rradhazi janë paraqitur dy urgjenca për trajtim të kundërshtimit.

Në një situatë të tillë, Autoriteti Kompetent pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të ankuesit të paraqitur kundër gjyqtares Lela Petković, si dhe pas vlerësimit me shkrim të deklaratës së gjyqtares Petković, sa i përket mosaktimit të seancës sipas kundërshtimit edhe përkundër dy urgjencave të parashtruara, ka vlerësuar se duke mos caktuar seancën dëgjimore sipas rregullave ligjore, subjekti i hetimit mund të ketë kryer shkelje disiplinore të përcaktuara nga neni 5, paragrafi 2, pika 2.7 të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 24 nëntor 2022, ka themeluar panelin hetimor për rastin disiplinor AD/KGJK/16/2022/ GJTHFR -ADGJTHFR.nr.08/22. Paneli hetimor i ka paraqitur Këshillit raportin mbi faktet dhe provat e mbledhura me datë 24 janar 2023.

Me datë 23 shkurt 2023, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka mbajtur seancën dëgjimore në të cilën kanë marrë pjesë kryesuesi i panelit hetimor gjyqtari Luan Berisha dhe subjekti i hetimit disiplinor gjyqtarja Lela Petković.

Kryesuesi i panelit hetimor para Këshillit deklaroi se ka zhvilluar procedurën disiplinore duke u bazuar në rregulla ligjore dhe i ka administruar të gjitha provat sa i përket pretendimit të Autoritetit Kompetent lidhur me shkeljen disiplinore të supozuar nga ana e gjyqtares Petković. Më tutje, kryesuesi i panelit hetimor ka theksuar se qëndron pranë të gjeturave në raport dhe kërkon nga Këshilli që të vlerësojë se a ka apo nuk ka shkelje disiplinore nga subjekti i hetimit.

Subjekti i hetimit disiplinor znj. Petkovic, në seancën e Këshillit deklaroi se kundërshton në tërësi iniciimin e procedurës disiplinore nga Autoriteti Kompetent, sepse sipas saj nuk ka kryer shkelje disiplinore të supozuara dhe rasti kontestues është zhvilluar bazuar në rregullat ligjore. Sipas subjektit të hetimit nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit se edhe pse i ka parashtruar dy urgjencat dhe kundërshtimin kundër Aktvendimit C.nr.2022.025970, e njehta nuk i ka shqyrtuar, kjo për faktin se gjyqtarja Petkovic nuk ka qenë në dijeni për ardhjen e tyre. E njehta është njoftuar për ekzistimin e këtyre shkresave me datë 5 gusht 2022, kur është ftuar nga kryetari i gjykatës, dhe është pyetur lidhur me rastin. Më tutje, subjekti i hetimit e njoftoi Këshillin se dy urgjencat po i pranon për herë të parë në këtë seancë nga Këshilli.

Këshilli, në seancën dëgjimore me datën 23 shkurt 2023, ka vendosur që ta kthej raportin e panelit në plotësim, duke kërkuar që të konstatohet data e pranimi të kundërshtimit dhe parashtrësve nga ana e gjyqtares në fjalë.

Këshilli, pas pranimi të raportit plotësues nga paneli hetimor, me datë 28 korrik 2023, ka caktuar seancën e dytë dëgjimore, në të cilën kanë prezantuar kryesuesi i panelit dhe subjekti i hetimit. Kryesuesi i panelit hetimor në këtë seancë deklaroi se bazuar në të dhënat e pranuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj, nuk është konfirmuar data e saktë e pranimi të kundërshtimit dhe dy urgjencave nga ana e subjektit të hetimit disiplinor.

Ndërsa subjekti i hetimit disiplinor deklaroi se qëndron pranë të gjitha deklaratimeve që i ka dhënë në seancën dëgjimore të mbajtur në Këshill me datë 23 shkurt 2023.

Për të vërtetuar këtë çështje disiplinore Këshilli i administroj këto prova: Kërkesën për fillim të hetimit disiplinor të pranuar nga Autoriteti Kompetent me datë 22 gusht 2022; Urgjencat e datës 30 maj 2022, dhe 14 qershor 2022; Padinë për masë të përkohshme të parashtruar nga paditsja

nga fshati Drobesh, Komuna Viti, të datës 04 shkurt 2022; Atkvendimin C.nr.2022:025970; Kundërshtimin e datës 26 prill 2022; Transkriptin e panelit hetimor lidhur me seancën dëgjimore të mbajtur me datë 27 dhjetor 2022; Raportin plotësues të panelit hetimor, të pranuar me datë 08 maj 2023; Njoftimin e gjykatës përkatësisht administratorit të Gjykatës Themelore në Ferizaj lidhur me kërkesat e panelit hetimor, sa i përket pranimit të urgjencave dhe të kundërshtimit; dhe Transkriptin e seancës dëgjimore të panelit të mbajtur me datë 19 prill 2023.

Këshilli nga provat e administruara gjatë seancës dëgjimore nuk ka mundur të vërtetojë datat e sakta se kur subjekti i hetimit gjyqtarja Petkoviq ka pranuar përmes sistemit SMIL dhe në kopje fizike, urgjencat dhe kundërshtimin e parashtruar nga ankuesi z. Ahmeti.

Prandaj, Këshilli në seancën për këshillim dhe votim në mënyrë unanime konstatoi dhe vendosi se në mungesë të provave me të cilat do të ishte konstatuar data e pranimit të parashtrësive të cekura më lartë nga gjyqtarja Lela Petkoviq, vendosi që ta liroj nga përgjegjësia disiplinore sa i përket pretendimeve të Autoritetit Kompetent për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, nënparagrafi 2.7 i Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Nga se u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KGJK.nr.382/2023, datë 28 korrik 2023.

Albert ZOGAJ
Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor i Kosovës



Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Kopje e vendimit i dorëzohet:

- Mustaf Tahiri, kryetar i Gjykatës Themelore në Ferizaj;
- Lela Petkoviq, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Ferizaj.